



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME**  
Nr.01-060/01-6636 datë:01.03.2018



**Npi – 01/30 datë: 09.03.2018**

Bazuar në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Neneve 32, dhe 37 të Statutit të Komunës së Shitimes; Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së Nr.02/2015; Si dhe në bazë të nenit 3.4 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve 01Nr.06/2005-43, Kryesuesi i Kuvendit vendosi të bëjë këtë:

**F T E S Ë**

**PËR MBLEDHJEN E -II- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË  
KOMUNËS SË SHITIMES PËR VITIN 2018**

E cila do të mbahet më datën: **09.03.2018 (e premte)** Në ora: **10.<sup>oo</sup>h**

Adresë: Kuvendi i Komunës Rruga: "Tahir Sinani" Nr.30, Shitime	Ndërtesa e Komunës, Kati i dytë, Salla e re	tel. ++381- 0290-389-016 lok. 107 Orari i punës: 8-16 h
---	--	--

Për këtë mbledhje fillimisht i ftoj Delegatët e ri znj.Fatmire Ferati dhe z.Milot Deliu që para Kuvendit të Japin Betimin Solemn. Në vazhdim propozojë këtë:

**R E N D I T E**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt procesverbalit nga mbledhja Kuvendit më: 31.01.2018,
2. Propozim-Vendim për caktimin e Orarit të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit për vitin 2018,
3. Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2018,
4. Propozim-Vendim për ndryshimin e neneve 4.2, 4.3 dhe 6.4 të Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoha për vitin 2018, Nr.01/251 datë: 15.09.2017,
5. Raporti vjetor Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017,
6. Propozim-Vendim për ndarjen e të Hyrave Vetanake të bartura nga viti 2017 në vitin 2018,
7. Rishqyrtimi i Vendimit Nr.01/254-2017 për caktimin e lokacionit për Deponi për mbeturinat e ngurta, sipas kërkesës së MAPL-së,
8. Rishqyrtimi i Vendimit Nr.01/23 për zgjedhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, sipas kërkesës të MAPL-së,
9. Propozim-Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi,
10. Shqyrtimi i Kërkesave,
11. Pyetje - Përgjigje të delegatëve,



Kryesuese e Kuvendit  
Medina Brahaj



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
Nr.01-060/01-6636 datë:01.03.2018



Npi – 01/34 datë: 09.03.2018

Duke u Bazuar në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, në Nenin 35 të Statutit të Komunës si dhe nenin 3.5 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 09.03.2018 aprovoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR CAKTIMIN E ORARIT TË MBLEDHJEVE TË RREGULLTA  
TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2018**

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më: 09.03.2018 aprovoi orarin për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Shtimes për vitin 2018, si vijon:

<i>Nr.</i>	<i>Data</i>	<i>Muaji</i>	<i>Viti</i>	<i>Dita</i>	<i>Ora</i>
1	31	Janar	2018	e merkurë	10.00
2	09 mars	Mbledhja e Shkurtit	2018	e premte	10.00
3	29	Mars	2018	e enjte	10.00
4	30	Prill	2018	e hënë	10.00
5	31	Maj	2018	e enjte	10.00
6	20	Qershor	2018	e merkurë	10.00
7	9	Korrik	2018	e hënë	10.00
8	30	Gusht	2018	e enjte	10.00
9	27	Shtator	2018	e enjte	10.00
10	31	Tetor	2018	e merkurë	10.00
11	29	Nëntor	2018	e enjte	10.00
12	27	Dhjetor	2018	e enjte	10.00

**II**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Kryesuesit, Kryetarit të Komunës, OSBE-së, Anëtarëve të Kuvendit, Zyres për Informim, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
Nr.01-060/01-6636 datë:01.03.2018



Npi – 01/35 datë: 09.03.2018

Duke u Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe Statutin e Komunës së Shtimes, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 09.03.2018 aprovoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2018**

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 09.03.2018, unanimisht aprovoi Vendimin për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2018, në këtë përbërje:

1. Shefki Dauti - përfaqësues nga pozita
2. Arbresha Sylja - përfaqësuese nga pozita
3. Naim Zejna - përfaqësues nga pozita
4. Adelina Beqaj - përfaqësuese nga opozita
5. Diarta Vishesella - përfaqësuese nga opozita

**II**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Anëtarëve të Komisionit, Kryesuesit, Kryetarit të Komunës, Zyres për Informim, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
Nr.01-060/01-6636 datë:01.03.2018



Npi – 01/36 datë: 09.03.2018

Kuvendi i Komunës duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) nenin 40.2 pika (g), Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës, harmonizimin e neneve 4.2, 4.3 dhe 6.4 të Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba për vitin 2018, Nr.01/251 datë: 15.09.2017, sipas Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe Udhëzimit Administrativ me Nr.01/2017. Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi të gjitha shkresat e propozimit të Drejtorisë dhe aprovoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR HARMONIZIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA  
PËR VITIN 2018**

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më: 09.03.2018, me shumicën e votave aprovoi vendimin për ndryshimin dhe harmonizimin e Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2018, me Udhëzimin Administrativ të MMPH, me Nr.01/2017 si vijon:

- Neni 4.2. "Taksa Administrative për lëshimin e Lejes Ndërtimore për tërë territorin e Komunës së Shtimes, ndryshon nga 1.40€ /m<sup>2</sup>, në 1.50€ /m<sup>2</sup>.
- Neni 4.3 "Taksa nga rritja e Densitetit të Infrastrukturës për tërë territorin e Komunës së Shtimes, ndryshon nga 108.90€, në 150.72€.
- Neni 6.4.1 shlyhet, dhe krijohen dy pika të reja të këtij neni ku thuhet si vijon:  
6.4.1 Në vleren investive të projektit deri në 25.000€ paguhet tarifa në vlerë 50 €.  
6.4.2 Në vleren investive të projektit mbi 25.000€ paguhet tarifa 0.2%, të vlerës investive të projektit.

**II**

Të gjitha ndryshimet e aprovuara me këtë vendim do të inkorporohen në Rregulloren Komunale për Taksa Tarifa dhe Gjoba për vitin 2018 me numër Nr. 01/251 datë: 15.09.2017.

**III**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
Nr.01-060/01-6636 datë:01.03.2018



Npi – 01/37 datë: 09.03.2018

Duke u bazuar në nenin 40.2.d, nenin 58 pika (j), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 45.4 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, si dhe mbi bazën e prezentimit të Raportit financiar për vitin 2017, nga Zyra Komunale për Financa, Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 09.03.2018, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËR APROVIMIN E RAPORTIT FINANCIAR TË KOMUNËS SË SHTIMES  
PËR VITIN 2017**

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 09.03.2018, me shumicën e votave aprovoi, Raportin Financiar të Komunës së Shtimes, për vitin 2017.

**II**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
 Nr.01-060/01-6636 datë:01.03.2018



Npi – 01/38 datë: 09.03.2018

Në bazë të nenit 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 58.3 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, si dhe nenit 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Kuvendi i Komunës pasi analizoi propozimin e Zyrës Kryesore Financiare në mbledhjen e mbajtur më 09.03.2018, aprovoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR APROVIMIN E NDARJES SË TË HYRAVE TË BARTURA NGA VITI 2017**

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e dytë, të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më: 09.03.2018, unanimisht aprovoi Vendimin për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2017, sipas kësaj tablele në vazhdim:

Nr	Kodi i OB	Kodi Ekonomik	Kodi i propozuar i programit për vitin 2018	Kodi i projektit në vitin 2018	Programi Buxhetor	Emërtimi i projektit	Ndryshimi i propozuar për vitin 2018 në €
1	617	30	660(66340)	45315	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Projektet e infrastruktures me participim	59,853.70
2		30	660(66340)	45210	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Pagesa për shpronsimet	39,580.00
3		30	660(66340)	40473	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Rregullimi i rrugeve bujqësore	5,000.00
4		30	660(66340)	45885	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Hapja e kanaleve te tokave bujqesore ne Vojnovc	10,000.00
5		30	660(66340)	45609	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Ndertimi i kanalizimeve ne Mollopolc	5,000.00
6		30	660(66340)	45178	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Asfaltimi rrugeve dhe kanaleve te ujrave te zeza ne Pjetershticë	10,000.00
7		30	660(66340)	47014	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Rregullimi i rrugeve dhe trotuareve ne fshetin Gilavicë	4,571.97
8		30	166 (16613)	40462	Inspekcioni	Rregullimi dhe përmirësimi i infrastruktures në Komunë	15,217.00
9		30	850(85007)	45373	Kultur Rini dhe Sport	Rregullimi i objektit të Shtabit të UÇK- së në Pjetershticë	10,000.00
10		13	920(94380)		Arsimi i Mesem	Mallra dhe Sherbime	3,500.00



Npi – 01/39 datë: 09.03.2018

Në bazë të nenit 12.2 pika (d), nenin 17 pika (c) dhe (f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40; Neni 15, 33.3.3 dhe 40 të Ligjit për Mbeturina Nr.04/L-060; Kuvendi i Komunës pasi analizoi Propozimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor Nr.4790-2/17 të datës 18.01.2018, nëpërmjet Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, për Rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/254, të datës 15.09.2017, Vendim për caktimin e lokacionit për deponimin e mbeturinave të ngurta në komunën e Shtimes, analizoi edhe shkresën Nr.02/31, dt.31.01.2018, të Zyrtarit Ligjor për Interpretim Ligjor të këtijë Vendimi, Kuvendi pas shumë diskutimeve, në mbledhjen e mbajtur më 09.03.2018, vendosi të Korrixhoi Vendimin Npi-01/254, të datës 15.09.2017, dhe aprovoi këtë:

### **V E N D I M**

#### **PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR DEPONINË E MBETURINAVE INERTE**

##### **I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e dytë, të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më datën 09.03.2018, unanimisht vendosi të aprovoi Vendimin për caktimin e lokacionit për deponinë e mbeturinave Inerte për banorët e Komunës së Shtimes, në pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr.6-69, me sipërfaqe prej 6129 m<sup>2</sup>, dhe pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr.6-70, me sipërfaqe 10926 m<sup>2</sup>. Me sipërfaqe të përgjithshme prej: 17055 m<sup>2</sup> (një hektarë e shtatëdhjetë ari e pesëdhjetë e pesë metra). Zona Kadastrale - Belinc. Evidentuar, Pasuri Shoqërore e Ekonomisë Pyjore.

##### **II**

Shfrytëzimi i Lokacionit për hudhjen e mbeturinave Inerte sipas dispozitivit të këtijë vendimi do të bëhet për 5 (pesë) vite nga dita e nënshkrimit të Kontratës. Pagesa sipas çmimit prej 0,20€/m<sup>2</sup> në vitë, ndërkaq për sipërfaqen e përgjithëshme prej 17055 m<sup>2</sup> Komuna nga Buxheti do të paguaj shumën vjetore prej: 3,411 € (tremijë e katërqind e njëmbëdhjetë euro) në 60 këste vjetore, ndërsa këstin e parë në shumën prej 284.25 € në llogarinë e Agjensionit të Ekonomisë Pyjore.

##### **III**

Mbikëqyrjen e deponisë do ta bëjë kompania e licencuar për menaxhimin e mbeturinave të ngurta e cila do të zgjidhet në bazë të konkursit të hapur publik.

##### **IV**

Ky vendim obligon të gjithë qytetarët dhe bizneset që mbetjet e ngurta të dërgohen në këtë deponi dhe në asnjë vend tjetër.



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
Nr.01-060/01-6636 datë:01.03.2018



Npi – 01/40 datë: 09.03.2018

Duke u bazuar në nenin 12, dhe 51 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Nenin 34 të Statutit të Komunës së Shtimes Nr.01-06/1636, dt. 03.09.2008, Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 09.03.2018, korrigjoi vendimin e Kuvendit Nr.01/060/01-2091-23 të datës 31.01.2018 dhe aprovoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR ZGJEDHJEN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2018, e mbajtur më datën: 31.01.2018, unanimisht aprovoi Vendimin për Korrigjimin e Vendimit të Kuvendit Nr.01/060/01-2091-23 të datës 31.01.2018, dhe zgjodhi Komitetin për Politikë dhe Financa në këtë përbërje:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësimi
1	Medina Brahaj	Kryesuese e Komitetit nga (PDK)
2	Perparim Ramusa	Anëtar i Komitetit nga (PDK)
3	Arbresha Syla	Anëtare e Komitetit nga (PDK)
4	Naim Zejna	Anëtar i Komitetit nga (LDK)
5	Zarife Rexhaj	Anëtare e Komitetit nga (LDK)
6	Ruzhdi Jashari	Anëtar i Komitetit nga (LVV)
7	Adelina Beqaj	Anëtare e Komitetit nga (NISMA)

**II**

Vendimi i mëparshëm i Kuvendit të Komunës së Shtimes, Nr.01/060/01-2091-23 i datës 31.01.2018, për zgjedhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, shfuqizohet.

**III**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Antarëve të Komitetit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj





REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME  
Nr.01-060/01-6636 datë:01.03.2018



Npi – 01/41 datë: 09.03.2018

Duke u bazuar në nenin 12, nenin 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Nenin 34 të Statutit të Komunës së Shtimes Nr.01-06/1636, dt. 03.09.2008, Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 09.03.2018, korrigjoi vendimin e Kuvendit Nr.01/060/01-2091-24 të datës 31.01.2018 dhe aprovoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR ZGJEDHJEN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE**

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2018, e mbajtur më datën: 09.03.2018, unanimisht aprovoi Vendimin për Korrigjimin e Vendimit të Kuvendit Nr.01/060/01-2091-24 të datës 31.01.2018, dhe zgjodhi Komitetin për Komunitete në këtë përbërje:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësimi
1	Fatmire Ferati	Anëtare e Komitetit nga (PDK)
2	Diarta Vishesella	Anëtare e Komitetit nga (AAK)
3	Muhamet Ademaj	Anëtar i Komitetit nga (AKR)
4	Rrahman Kadrija	Anëtar i Komitetit nga komuniteti ashkali (PAI)
5	Xhevahire Ramadani	Anëtare e Komitetit nga komuniteti ashkali (PAI)
6	Ruzhdi Brahimi	Anëtar i Komitetit nga komuniteti ashkali (PDAK)
7	Arton Demiri	Anëtar i Komitetit nga komuniteti rom (PRIPK)

**II**

Vendimi i mëparshëm i Kuvendit të Komunës së Shtimes, Nr.01/060/01-2091-24 i datës 31.01.2018, për zgjedhjen e Komitetit për Komunitete, shfuqizohet.

**III**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Antarëve të Komitetit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
Nr.01-060/01-6636 datë:01.03.2018



Npi – 01/42 datë: 09.03.2018

Duke u bazuar në nenin 12 dhe nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Nenin 34.2 të Statutit të Komunës së Shtimes, Nr.01-06/1636, dt. 03.09.2008, Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 09.03.2018, korrigjoi vendimin e Kuvendit Nr.01/060/01-2091-25 të datës 31.01.2018 dhe mori këtë:

**V E N D I M**

**PËR ZGJEDHJEN E KOMITETIT PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT**

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2018, e mbajtur më datën: 09.03.2018, unanimisht aprovoi Vendimin për Korrigjimin e Vendimit të Kuvendit Nr.01/060/01-2091-25 të datës 31.01.2018, dhe zgjodhi Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në këtë përbërje:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësimi
1	Shefki Dauti	Anëtar i Komitetit (PDK)
2	Reshat Mujota	Anëtar i Komitetit (PDK)
3	Valentina Halili-Ferati	Anëtare e Komitetit (LDK)
4	Besnik Seferi	Anëtar i Komitetit (LVV)
5	Fehmi Hysenaj	Anëtar i Komitetit (NISMA)

**II**

Vendimi i mëparshëm i Kuvendit të Komunës së Shtimes, Nr.01/060/01-2091-25 i datës 31.01.2018, për zgjedhjen e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, shfuqizohet.

**III**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Antarëve të Komitetit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME  
Nr.01-060/01-6636 datë:01.03.2018



Npi – 01/43 datë: 09.03.2018

Duke u bazuar në nenin 12 dhe nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Nenin 34.2 të Statutit të Komunës së Shtimes. Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 09.03.2018, korrigjoi vendimin e Kuvendit Nr.01/060/01-2091-26 të datës 31.01.2018 dhe aprovoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR ZGJEDHJEN E KOMITETIT PËR SHËNDETËSI, MIRËQENIE SOCIALE,  
AMBIENT DHE SHËRBIME PUBLIKE**

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2018, e mbajtur më datën: 09.03.2018, unanimisht aprovoi Vendimin për Korrigjimin e Vendimit të Kuvendit Nr.01/060/01-2091-26 të datës 31.01.2018, dhe zgjodhi Komitetin për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient dhe Shërbime Publike, në këtë përbërje:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësimi
1	Shefki Dauti	Anëtar i Komitetit nga (PDK)
2	Herolind Selmani	Anëtar i Komitetit nga (PDK)
3	Milot Deliu	Anëtar i Komitetit nga (PDK)
4	Skender Hyseni	Anëtar i Komitetit nga (LDK)
5	Marigona Pajaziti	Anëtare e Komitetit nga (LVV)
6	Isak Muslija	Anëtar i Komitetit nga (AAK)
7	Rexhep Gashi	Anëtar i Komitetit nga (LB)

**II**

Vendimi i mëparshëm i Kuvendit të Komunës së Shtimes, Nr.01/060/01-2091-26 i datës 31.01.2018, për zgjedhjen e Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient dhe Shërbime Publike, shfuqizohet.

**III**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Antarëve të Komitetit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME  
Nr.01-060/01-6636 datë:01.03.2018



Npi – 01/44 datë: 09.03.2018

Duke u bazuar në nenin 7 të Ligjit për Policinë e Kosovës Nr.04/L-076, si dhe nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës - Shtime, aprovoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI**

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më: 09.03.2018, unanimisht aprovoi vendimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në Komunën e Shtimes, në këtë përbërje:

1. z.Naim Ismajli,..... Kryetar i Komunës,
2. z.Enver Avdyli ..... Komandant i Policisë – Shtime,
3. z.Isak Demiri ..... Përfaqësues nga Forca e Sigurisë së Kosovës,
4. z.Isa Tërshani .....Përfaqësues Bashkësis Fetare dhe Imam – Shtime,
5. z.Mensur Neziri ..... Drejtor i Drejtorisë për Arsime,
6. z.Skender Dauti ..... Zyra Komunale për Emërgjencë,
7. z.Ibrahim Demiri ..... Shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim,
8. z.Reshat Gashi ..... Zyrtar për Barazi Gjinore,
9. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete pranë Kuvendit të Komunës së Shtimes,
10. z.Shefki Osmani ..... Përfaqësues i Komitetit Ashkalinjë,
11. z.Arton Demiri ..... Përfaqësues i Komitetit Rom,
12. z.Muhadin Halili ..... Kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi,
13. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Shtimes,
14. z.Lulzim Vishesella ..... Përfaqësues i OJQ-ve, Mediet Lokale, Komitetit të Biznesit, dhe Komiteti i personave me aftësi të kufizuara.

**II**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj